



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Nr. _____, datë ____ . ____ . 2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
Nr. _____, datë ____ . ____ . 2011

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 2, datë 07.11.2011

“PËR KRYERJEN DHE PËRFUNDIMIN E HETIMEVE TË KALLËZUARA DREJTPËRDREJT NË PROKURORI APO TË FILLUARA KRYESISHT”

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, germa ògjò e ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 òPër organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), të nenit 8/a, pika 3 e ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 òPër organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore (i ndryshuar) si dhe të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 òPër Policinë e Shtetit,

U D H Ë Z O J M Ë:

Neni 1

Përfundimi i hetimeve nga Seksionet e Policisë Gjyqësore

1. Seksionet e Policisë Gjyqësore, të ngritura pranë prokurorive, si rregull, përfundojnë veprimet procedurale në rastet kur:

- a) personeli i seksionit të Policisë Gjyqësore merr dijeni për veprën penale dhe ja referon prokurorit;
- b) kallëzimi bëhet drejtpërdrejt në prokurori;
- c) prokurori fillon një procedim kryesisht;
- ç) institucioni që ka referuar veprën penale, nuk ka shërbim të Policisë Gjyqësore, si ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 7 të Ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 òPër organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, i ndryshuar;
- d) institucioni që ka bërë referimin ka shërbim të Policisë Gjyqësore, por nuk ka shërbim të posaçëm për hetimin e veprës konkrete penale, si ato të parashikuara në pikën 3 të nenit 7 të Ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 òPër organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, i ndryshuar;
- dh) jemi para rastit të parashikuar në pikën 2 të nenit 8/a të Ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 òPër organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore (i ndryshuar).

2. Me vënien e vendimit gjyqësor në ekzekutim, Prokurori njeh shërbimin e Policisë Gjyqësore që ka kryer veprimet hetimore.

Neni 2 Delegimi i hetimit shërbimit të Policisë Gjyqësore

1. Prokurori, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, mund të urdhërojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, duke:
 - a) deleguar veprime të caktuara procedurale një shërbimi të caktuar të Policisë gjyqësore;
 - b) deleguar për kryerjen e plotë të hetimit paraparak një shërbim të caktuar të Policisë Gjyqësore;
2. Prokurori urdhëron kryerjen e veprimeve të caktuara dhe/ose përfundimin e veprimeve procedurale shërbimeve të policisë Gjyqësore, përveç rasteve kur ai e çmon vetë, edhe kur:
 - a) ka një shërbim të posaçëm të Policisë Gjyqësore të ngritur pranë një institucioni publik, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit nr. 8677, datë 02.11.2000 ÷Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, i ndryshuar;
 - b) kërkohen njohuri të specializuara dhe/ose aplikim i teknikave speciale të hetimit;
 - c) autorizohet aplikimi i veprime simuluese;
 - ç) kërkohet ndërthurja e veprimeve gjurmuese në terren me ato procedurale;
 - d) kërkohet të aplikohen teknika të ÷survejimit ndërkufitarë, sipas ligjit nr. 9604, datë 11.9.2006 ÷Për ratifikimin e "Konventës së bashkëpunimit policor për Evropën juglindore".
3. Prokurori i dërgon me shkrim shërbimit të Policisë Gjyqësore, pas konsultimit paraparak me drejtuesin e shërbimit kur është e mundur, detyrat e deleguara, ku veç të tjerash duhet detyrimisht të parashikohen:
 - a) shërbimi përkatës i Policisë Gjyqësore që ngarkohet me kryerjen e veprimeve procedurale, dhe kur është e përshtatshme, grupin apo seksionin që delegohet me kryerjen e veprimeve;
 - b) detyrat konkrete që duhet të realizohen dhe afati i zbatimit;
 - c) data e zhvillimit të analizës për kryerjen e detyrave të deleguara.
4. Në raste të urgjencave, prokurori komunikon me gojë apo me mjete të shpejta të komunikimit me drejtuesin e shërbimit të Policisë Gjyqësore, dhe urdhëron kryerjen e veprimeve të caktuara procedurale. Drejtuesi i shërbimit dhe oficeri të cilit i janë deleguar detyra, është i detyruar të kryejë ato dhe mbajnë përgjegjësi për zbatimin në kohë dhe cilësinë e zbatimit.
5. Prokurori kur ndodhet para rastit të parashikuar në pikën 4 të nenit 2 të këtij udhëzimi, në një kohë sa më të shkurtër, por në të gjitha rastet pa kaluar 5 ditë, dërgon zyrtarisht detyrat e deleguara shërbimit të Policisë Gjyqësore.

6. Në përfundim të afatit të delegimit të veprimeve procedurale, oficeri/ët e Policisë Gjyqësore, paraqesin informacion me shkrim si për rezultatin e përfutur ashtu edhe për detyrat e parealizuara, duke përfshirë dhe arsyet që kanë çuar në moskryerjen e veprimeve në afatin e caktuar. Ky informacion i shkon prokurorit që drejton hetimin nëpërmjet oficerit të Policisë Gjyqësore të nivelit drejtues më të lartë për shërbimin ku bën pjesë oficeri/ët që i ishin deleguar veprimet.

Neni 3

Krijimi i grupeve të përbashkëta hetimore

1. Prokurori, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes, mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo përfundimin e veprimeve procedurale nga grupe hetimore të përbashkëta ndërmjet shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore, përveç rasteve kur ai çmon vetë, edhe kur:

- a) ekzistojnë format e veçanta të bashkëpunimit për kryerjen e veprave penale;
 - b) hetohet në lidhje me krime veçanërisht të rënda;
 - c) veprimet procedurale janë të shumta, e kërkohet bashkërendimi me veprimet gjurmuese policore në terren;
 - ç) subjektet e proceduara vazhdojnë aktivitetin kriminal dhe/ose numri i tyre është i madh;
 - d) hetohet paralelisht edhe në drejtim të aseteve që kanë rrjedhur nga veprimtaria kriminale;
- dh) zhvillohen hetime të përbashkëta për krime ndërkufitare dhe ndërkombëtare.

2. Kur çmohet sipas pikës 1 të këtij neni, se duhet të ngrihet një grup i përbashkët hetimor, drejtuesi i prokurorisë që ndjek hetimin, njofton më shkrim titullarin e institucionit ku është ngritur dhe funksionon shërbimi apo që ka punonjës që ligji u jep atributet e Policisë Gjyqësore. Njoftimi duhet të përmbajë detyrimisht:

- a) të dhëna të përgjithshme në lidhje me procedimin;
- b) shërbimin apo shërbimet, përfshirë edhe ato të posaçme ku duhet të përzgjidhen oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore për të qenë pjesë e grupit të përbashkët hetimor;
- c) mendimin për numrin e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore që kërkohen të bashkohen grupit hetimor, apo atij që do të krijohet. Kur është e mundur, propozohen edhe emrat konkretë të oficerëve dhe agjentëve;
- ç) parashikimin nëse oficerët dhe agjentët e shërbimit të Policisë Gjyqësore do të ngarkohen me kohë të plotë apo të pjesshme me hetimin konkret;
- d) afatin që parashikohet të funksionojë grupi hetimor.

3. Titullari i institucionit ku është ngritur dhe funksionon shërbimi apo që ka punonjës që ligji u jep atributet e policisë gjyqësore, ka të drejtë të sugjerojë:

- a) ndryshimin e numrit të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore që do të caktohen në përbërje të grupit hetimor;
- b) oficerët dhe agjentët konkretë, qoftë dhe ndryshimin e atyre të propozuar nga prokurori, duke argumentuar sugjerimin;
- c) përdorimin e ambienteve, teknikave, pajisjeve, metodave etj. që lidhen me kapacitete teknike, e që mund t'ia shërbejnë kryerjes së veprimtarisë procedurale;
- ç) përfshirjen edhe të shërbimeve të tjera të posaçme të Policisë Gjyqësore që nuk janë parashikuar në kërkesën e drejtuesit të prokurorisë.

4. Për rastet kur e gjykon, titullari i institucionit, sipas pikës 3 të këtij neni, mund të marrë iniciativën për t'ia kërkuar drejtuesit të prokurorisë që ndjek hetimin, ngritjen e një grupi të përbashkët hetimor për një çështje apo grup çështjesh të caktuara.

4.1. Kur prokurori nuk e pranon kërkesën për ngritjen e grupit të përbashkët hetimor, njofton me shkrim kërkuuesin, duke parashtruar arsyet.

4.2. Prokurori përgjigjet brenda 30 ditëve në lidhje me kërkesën e titullarit të institucionit, ku është ngritur dhe funksionon shërbimi apo që ka punonjës që ligji u njeh atributet e policisë Gjyqësore.

5. Prokurori që drejton hetimin nxjerr urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët hetimor.

5.1. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët hetimor, prokurori cakton edhe oficerin përgjegjës të këtij grupi.

6. Për rastet e ndryshimit të përbërjes, numrit, apo oficerëve dhe agjentëve që bëjnë pjesë në grupet e hetimit, ndiqet e njëjta procedurë si edhe për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore, gjithmonë duke respektuar rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale për zëvendësimin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

7. Oficerët dhe agjentët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore të përfshirë në grupet e përbashkëta hetimore, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, nuk mund të transferohen në detyra pa miratimin me shkrim të drejtuesit të prokurorisë që ndjek hetimin. Ngritja në gradë dhe ecuria në karrierë nuk mund të pengohen nga pjesëmarrje në një grup të përbashkët hetimor.

8. Në rastet kur oficeri dhe/ose agjenti i policisë Gjyqësore të shërbimit, është caktuar me kohë të plotë pune pranë një grupi të përbashkët hetimor, drejtuesi i prokurorisë njofton menjëherë me shkrim titullarin e institucionit, sipas pikës 3 të këtij neni, për përfundimin e punës së oficerit dhe/ose agjentit të policisë Gjyqësore në grupin e përbashkët hetimor.

Neni 4

Njohja e prokurorit me organizimin e shërbimit të Policisë Gjyqësore

1. Oficeri i Policisë Gjyqësore i nivelit drejtues më të lartë për shërbimin si dhe titullari i institucionit që ka punonjës që ligji u njeh atributet e Policisë Gjyqësore, i paraqesin drejtuesit të prokurorisë kompetente:

- a) organizimin, strukturën dhe objektin e veprimtarisë të shërbimit;

- b) listën e emrave, nivelin dhe gradën përkatëse të punonjësve që bëjnë pjesë në shërbimet e Policisë Gjyqësore. Kjo listë përditësohet në rastet e transferimeve, ngritjeve në detyrë ose largimeve nga detyra të punonjësve brenda 10 ditëve.

2. Aktet administrative të organizimit të shërbimit si dhe listat emërore të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore, i dërgohen drejtuesit të prokurorisë kompetente brenda 5 ditëve nga përditësimi i tyre.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Mosrespektimi i kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim, passjell përgjegjësi disiplinore për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore.

2. Me njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët, punonjësit e Policisë së Shtetit si dhe punonjësit e institucioneve të tjera publike që ligji u njeh atributet e Policisë Gjyqësore.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

BUJAR NISHANI

INA RAMA